



Npi – 01/103 datë: 30.03.2023

Bazuar në nenin 12.2 pika (c) dhe 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 date 03.09.2008; Si dhe në bazë të Kërkesës të Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe teknologji Nr.06-1810 të datës 24.03.2023 për Rishqyrtimin e Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, Npi – 01/78 datë: 15.03.2023. Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e rregullt, të mbajtur më datën: 30.03.2023, miratoi këtë:

RREGULLORE

, PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË RREGULLORES KOMUNALE PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2023

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -III- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më: 30.03.2023, unanimisht, miratoi ndryshimet në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, Npi-01/78 të datës 15.03.2023, si vijon:

1. Te Neni 11, i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, Npi – 01/78, të datës 15.03.2023, bëhen këto ndryshime si vijon:

Neni 11

11.1 Duke u bazuar në U.A. të MASHT-it Nr.01/2017 të datës 21.02.2017 për Planifikimin dhe Shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur, pagesa për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimit për të rritur është:

11.1.1 Për regjistrimin e vitit.....	100.00 €
11.1.2 Për praktikë profesionale	50.00 €
11.1.3 Provimi diferencial.....	10.00 €
11.1.4 Provimi përfundimtar certifikatën/diploma.....	50.00 €

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Rregullorja u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi